

AKT THEMELIMI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“WINDOW TECH” SHPK

Në Tiranë, sot me datë **23.02.2022**

Z. Lordion Dengu, lindur me 02.07.1975 në Tirane, dhe banues në Tirane, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me karte identiteti me nr.personal **H 50702163 B**, I cili hartozi këtë Akt Themelimi të shoqërisë “**WINDOW TECH**” SHPK, mbështetur në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar dhe Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si me poshte :

Kreu 1

Neni 1

Krijimi

Shoqëria “**Window Tech**” SHPK, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (më posht e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitet juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Bisnezit (QKB), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj. Shoqëria “**Window Tech**” SHPK, është një shoqëri, që themelohet nga ortaku i saj i vetem dhe që përballon humbjen vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Selia e shoqërisë “**WINDOW TECH**” shpk është në adresën Tiranë, Vaqarr, RRuga e Prushit, Ndërtesë 2 katëshe, kati I 1, zona kadastrale 3712, nr. Pasurie 291/40



Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësimi, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortaku të vetëm të Shoqërisë.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie është **veprimtari kryesishë në fushat si më poshtë:**

- Prodhimin e dyerve, dritareve, fasadave etj me profile alumini;
- Prodhimin e dyerve, dritareve, fasadave etj me profile PVC
- Mundesi krijimi një “biznes chain”, apo rrjeti njesish tregtare Brenda & jashtë vendit per produkte te prodhuara nga shoqeria;
- Import & Eksport te produktave qe tregton shoqeria;

Neni 5

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike të Shoqërisë “Window Tech” SHPK është e pakufizuar dhe mund të shpërbëhet në çdo kohë. Shoqëria mund të ndryshojë emrin, selinë si dhe objektin e veprimtarisë së saj sipas vendimeve që do të marr ortaku i vetem.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100.000 (njeqindmije) lekë.



Kapital shoqërisë është ndarë ne 1 (një) pjesë kapitali (kuote) me vlerë nominale me 100.000 (njeqindmije) lekë. Kapitali mesiperm eshte nenshkruar nga ortaku i vetem i shoqerise, kuota me vlerë te pergjithshme 100.000 (njeqindmije) leke perbejne 100% të

Neni 7

Mënyra e fitimit dhe kalimit të kuotave

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet :
 - a) Kontributet në kapitalin e shoqërisë
 - b) Shitblerjes
 - c) Trashëgimisë
 - d) Dhurimit
 - e) Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
3. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjera.
4. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe moment i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotave hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimi i ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtezohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8



Organi Vendimmarrës

Ortaku i vetëm është i vetmi organ vendimmarrës i shoqërisë.

Ortaku i vetëm është i vetmi organ vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Ortaku i vetëm është i vetmi organ vendimmarrës i shoqërisë që është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme :

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- d) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur ne shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike;
- f) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) Miratimin e rregullave proçeduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.



Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakut të vetëm në asamblenë e përgjithshme.

Neni 9

Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga Z.Lordion Dengu sipas statutit dhe ligjit për një periudhë 5 (pse) vjeçare me të drejtë ripërtëritje.

Ortaku i vetem mund te shkarkojë administratorët në çdo kohë.

Statuti, apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.

Perveç kesaj, administratoret shkarkohen nga gjykata per shkelje te ligjit me kerkeset te ortakut të vetëm.

Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendrën Kombëtare të Biznesit. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe një person jashtë ortakut.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te :

- a) Kryeje te gjithe veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e përgjithshme
- b) Perfaqesoje shoqerine tregtare
- c) Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise
- d) Pergatisi dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, I paraqesin keto dokumente perpara asamblese se përgjithshme per miratim
- e) Krijoje një sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrëthanat, që kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise



- f) Kryeje regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit
- g) Raportoje perpara asamblese se per gjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare
- h) Kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratori ka te dreje te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem. Administratori perfaqeson Shoqerine perpara te gjitha personave fizik e juridik, publike dhe /ose private vendas apo te huaj, autoriteteteve shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkallevet, bankat e te gjitha niveleve etj. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, si perpara Bankave te te gjitha niveleve, per te kryer derdhje, terheqje, transferta, etj, perpara Zyrave te Tatim Taksave, Zyrave te punes, Autoriteteteve Doganore, etj, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakut te vetem te shoqerise. Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te trete nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Neni 11

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllte me 31 dhjetor.

Neni 12


Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plete me kete akt-themelimi, statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodi Civil dhe cfarëdo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 13

Mosmarreveshjet



Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u miratua ne parim nen per nen nga Ortaku i vetem i shoqerise tregtare **“WINDOW TECH” shpk**, dhe meqenese shpreh vullnetin e tij te lire u nenshkruan nga ortaku i vetem,,

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

“WINDOW TECH” SHPK

Lordion Dengu

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Lordion Dengu". The signature is fluid and cursive, with some loops and variations in line thickness.